



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

**Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot. Tiranë / /2025
Nr. Dok. 202501948/10

Lënda: Rekomandim për përshpejtimin e përfundimit të procedurës së kompensimit financiar të mbetur e akorduar për mbulimin e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësia natyrore, përmbytja e 9 mars 2010.

AGJENCISË KOMBËTARE TË MBROJTJES CIVILE

TIRANË

Për dijeni: MINISTRISË SË MBROJTJES

TIRANË

Të nderuar,

Sikurse jeni në dijeni institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë në shqyrtim ankesën e shtetasit z. Q. K. i cili ngre shqetësimin e tij për mosdhënien e pjesës së mbetur të ndihmës financiare, e akorduar për mbulimin e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësia natyrore, përmbytja e 9 marsit 2010.

Ankuesi shpjegon se, në mars të vitit 2010, si shkak i përmbytjes së ndodhur në zonën e Paskuqanit, Bashkia Kamëz, u dëmtua dhe banesa e tij private. Pasi u përgatit dosja me dokumentacionin e nevojshëm për marrjen e ndihmës nga Drejtoria e Përgjithshme e

Emergjencave Civile (DPEC), iu miratua dhe akordua fondi për të kryer riparimet e nevojshme për ta bërë banesën të banueshme.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga ankuesi, evidentohet se me shkresën nr. SH-33/2 prot., datë 15.05.2014, Drejtoria e Inspektimit të Përgjithshëm, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, informon znj. Sh. K. (bashkëshortja e ankuesit z. Q. K.) se: *“...Bazuar në këtë dokumentacion, preventivi nga ana ndërtimore për dëmtimin e banesës së z. Q. K., është në vlerën XXXXX lekë. Sipas VKM-së së sipërcituar, pika 4/42, për rastet e dëmtimit të banesave, ndihma falas do të jetë në masën 50% të vlerës së dëmit. Ju bëjmë me dije se z. Q. K., i është akorduar ndihmë financiare në vitin 2013, në vlerën XXX lekë. Detyrimi i mbetur i Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile është XXXXX lekë.”*

Në datën 12 dhjetor 2014, znj. Sh. K. paraqet ankesë pranë institucionit të Avokatit të Popullit për zgjidhjen e situatës, duke qenë se nuk po merrte pjesën e mbetur të ndihmës së akorduar. Në vijim, institucioni i Avokatit të Popullit, me shkresën nr. K3/SH79 – 2 prot., datë 20.01.2015, i ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile, *shqyrtimin e kërkesës së shtetases Sh. K. dhe trajtimin e saj me përparësi për mbulimin e shpenzimeve për pasurinë e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.*

Në përgjigje të rekomandimit të mësipërm, nga ana e DPEC-së jemi informuar në datën 25.02.2015 se, mundësia e dëmshpërblimit të ankueses do të shihet në të ardhmen, në varësi të fondeve të disponueshme. Gjithsesi, duke parë problematikën e saj, si edhe vështirësitë që ka patur, jemi informuar se ankuesja është vënë në listën prioritare për t’u trajtuar me ndihmë financiare gjatë vitit 2013, listë e cila duhet të zbatohet së shpejti.

Duke qenë se DPEC nuk zbatoi rekomandimin e dhënë nga Avokati i Popullit, institucioni ynë iu ridrejtua kësaj drejtorie në datën 10.10.2016, për *shqyrtimin dhe trajtimin përfundimtar të kërkesës së shtetases Sh. K. lidhur me mbulimin e shpenzimeve për pasurinë e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore”*.

Për vijimin e hetimit administrativ dhe sqarimin e fakteve e rrethanave, në zbatim të detyrimit kushtetues e ligjor, e konkretisht nenit 63, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet: *“Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara prej tij”*, si dhe pika b, e nenit 19, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 Për Avokatin e Popullit, të ndryshuar, ku parashikohet: *Në rastet kur vendos të kryejë hetime të pavarura, Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin*, i jemi drejtuar Bashkisë Kamëz dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) me shkresat nr. K3/Q3 – 5 prot., datë 20.12.2024, dhe nr. K3/Q3 – 7 prot., datë 22.01.2025, për të na dërguar informacionin dhe dokumentacionin përkatës lidhur me sa pretendohet si dhe veprimeve të ndërmarra nga institucionet tuaja, në kuadër të zgjidhjes të këtij shqetësimi.

Në përgjigje të sa më sipër, AKMC me shkresën nr. 242/2 prot., datë 29.01.2025 na bën me dije se: “...Bashkia Kamëz, nëpërmjet shkresës nr. 10533/1 prot., datë 20.12.2024, “Kthim përgjigje”, ka përcjellë dokumentacionin tekniko-ligjor për shtetasin Q. K. , ku ndër të tjera citon se shtetasit i është akorduar ndihmë financiare në vitin 2013, në vlerën XXXXX lekë. AKMC, në këto kushte, bazuar VKM-së nr. 2026, datë 26.03.1998, do të kryejë vlerësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për shtetasin Q. K. dhe sipas mundësive financiare do të realizojë kompensimin financiar. Gjithashtu, ju informojmë se, për vitin 2025 në buxhetin e AKMC-së nuk janë akorduar fonde për kompensimin financiar të shtetasve, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme. Për sa më sipër, AKMC, në mungesë të fondeve nuk mund të shprehet për afatin përfundimtar të gjenerimit të ndihmës financiare për shtetasin në fjalë.”

Ndërsa, Bashkia Kamëz me shkresën nr. 907/1 prot., datë 04.02.2025, na informon se: “...Nëpërmjet shkresës nr. 10533 prot, datë 12.12.2024, institucioni i AKMC-së na ka kërkuar vënien në dispozicion të dokumentacionit tekniko-ligjor për shtetasin Q. K. dhe Sh. K. të dëmtuar si pasojë e përmbajtjes së datës 09.03.2010. Nëpërmjet shkresës me nr.10533/1 prot., datë 20.12.2024, ne si institucion i kemi vënë në dispozicion institucionit të AKMC-së dhe për dijeni z. Q. K. fotokopje të dokumentacionit që ne disponojmë nga ish komuna Paskuqan...Referuar legjislacionit në fuqi në periudhën që ka ndodhur përmbajtja mbështetur në ligjin nr. 8652 prot., datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”; VKM-ja nr. 206 prot., datë 26.03.1998 “Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”; si detyrime të prapambetura”, deri në daljen e ligjit nr. 45, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen Civile”, detyrimet financiare janë të mbartura për institucionin e AKMC-së. Nga korrespondenca jonë ndërinstytucionale me institucionin e AKMC-së nuk rezulton të kemi patur kërkesë për plotësim dokumentacioni shtesë për rastin e z. Q. K.”

Sa më sipër, provohet fakti se edhe pse institucioni i Avokatit të Popullit, iu ka drejtuar dy rekomandime në vitet 2015 dhe 2016, situata e ankuesve nuk ka marrë zgjidhje ende deri më sot, pasi z. Q. K. dhe familja e tij janë ende në pritje për të marrë pjesën e mbetur të kompensimit në vlerën XXXX lekë.

Në këtë kontekst tërheqim vëmendjen se, edhe nga hetimi administrativ bazuar në korrespondencat zyrtare ka rezultuar që dokumentacioni tekniko-ligjor i plotë për rastin e familjes së Q. K. është disponuar nga DPEC, aktualisht AKMC. Arsyeja që kjo agjenci është një nga autoritetet e mbrojtjes civile, e cila si një institucion dhe strukturë qendrore ushtron përgjegjësinë e saj në drejtim të planifikimit të fondeve jo vetëm për marrjen e masave parandaluese, por edhe rehabilituese ndaj fatkeqësive, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Ndërsa vlerësojmë se, në ushtrim të funksioneve të AKMC dhe në përmbushje të përgjegjësisë të parashikuara në ligj, gjatë veprimtarisë administrative të AKMC lidhur me rastin rezulton mosveprim krejtësisht i pajustifikuar nga ana juaj në ushtrimin e kompetencave detyruese

ligjore, e për pasojë janë kryer veprime ose mosveprime që bien ndesh me frymën e parimeve të Kodit të Procedurës Administrative, e konkretisht konstatojmë se është cenuar:

- *Parimi i ligjshmërisë*, i cili parashikohet në nenin 4, të Kodit të Procedurës Administrative, ku parashikohet se: “*Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca*”.

- *Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë*, i cili parashikohet në nenin 13, të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: “*Në ushtrimin e funksioneve të tij, organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie*”.

- *Parimi i objektivitetit*, i cili sanksionohet në nenin 14, të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: “*Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative*.”

- *Parimi i deburokratizimit dhe i efikasitetit*, i cili parashikohet në nenin 18, paragrafi 2, i Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: “*Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm*”.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se veprimtaria administrative e AKMC, nuk është zhvilluar në përputhje me parimet ligjore mbi bazë të të cilit është normuar veprimtaria e këtij organi. Ushtrimi i detyrave sikurse parashikuar në ligj, është i detyrueshëm në këtë situatë në të cilën ndodhet çështja e prezantuar, pasi AKMC si një nga organet shtetërore të përcaktuara në ligj është përgjegjëse edhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga fatkeqësia, si në rasti konkret i familjes Q. K. , por edhe të familjeve apo shtetasve të tjerë të gjendur në të njëjtat kushte apo edhe në situatë më të përqekësuar që ndikohen nga efektet e fatkeqësive.

Referuar VKM-së nr. 747, datë 20.11.2019, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”, pika 5¹ parashikon fushat e përgjegjësisë dhe përgjegjësitë funksionale të Agjencisë, përveç detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ku në germën ç) parashikohet se hartimi dhe detajimi i buxhetit bëhet nga vetë Agjencia. Gjithashtu në germën k), të kreut III, mbi Organizimin dhe funksionimin e Agjencisë, parashikohet se: “*k) Mbledh informacion nga strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, qendrore dhe vendore, përmasat e marra për parandalimin e përballimin e fatkeqësive, si dhe të dhëna për dëmet e humbjet e pësura nga këto të fundit; si dhe Kreu IV “Dispozita Kalimtare dhe të Fundit”, parashikon se: “...Punonjësit, zyrat, ambientet e punës, mjetet,*

¹ Pika 5 e VKM-së nr. 747, datë 20.11.2019, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile” parashikon: “*Agjencia, në përputhje me misionin, fushat e përgjegjësisë dhe përgjegjësitë e saj funksionale, përveç detyrave të përcaktuara në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, kryen edhe detyrat, si më poshtë vijon:...*ç) Harton projektbuxhetin për realizimin e detyrave të Agjencisë, bën detajimin e buxhetit, si dhe monitoron përdorimin e fondeve përkundrejt planifikimit;...k) Mbledh informacion nga strukturat e sistemit të mbrojtjes civile, qendrore dhe vendore, për masat e marra për parandalimin e përballimin e fatkeqësive, si dhe të dhëna për dëmet e humbjet e pësura nga këto të fundit; l) Përgatit, çdo vit, raport drejtuar ministrit për gjendjen e përgjithshme të zvogëlimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile;”.

pajisjet, dokumentacioni dhe fondet buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile i kalojnë Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile.”

Kjo për të theksuar faktin se dokumentacioni që i është transmetuar AKMC-së nga Bashkia Kamëz nëpërmjet shkresës me nr.10533/1 prot., datë 20.12.2024, për një ngjarje të ndodhur në 9 mars 2010, bën të kuptohet se AKMC nuk ka trashëguar asnjë dokumentacion të kohës nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile. Pra një mungesë përgjegjësie dhe formë justifikuese e padrejtë për të moskompensuar detyrimet e prapambetura.

Në të njëjtën kohë Agjencia në zbatim të nenit 41, të ligjit nr. 45/2019, “E drejta e kompensimit” dhe “Për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve në raste fatkeqësish”; si detyrime të prapambetura”, deri në daljen e ligjit nr. 45, datë 18.07.2019, “Për mbrojtjen Civile”, detyrimet financiare janë të mbartura për institucionin e AKMC-së.

Konkretisht ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”:

- germa b, të pikës 2, të nenit 22, parashikon se: “2. Ministritë dhe institucionet qendrore kanë këto detyra: a) hartojnë, miratojnë dhe përditësojnë planin për emergjencat civile, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore dhe e dërgojnë atë në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile për qëllime analize dhe planifikimi; b) planifikojnë buxhet vjetor për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre shtetërore. Për ministritë përgjegjëse për mbrojtjen civile, mbrojtjen, punët e brendshme, transportin, infrastrukturën, bujqësinë, shëndetësinë, energjetikën, arsimin, mjedisin dhe kulturën, planifikimi buxhetor duhet të jetë nga 2 % deri në 4 % e totalit të buxhetit vjetor; c) organizojnë dhe mirëmbajnë sistemet e monitorimit, të paralajmërimit të hershëm, të njoftimit dhe të alarmit në fushën e veprimtarisë së tyre; ç) brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijojnë bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në fushën e përgjegjësisë së tyre, të cilën e mirëmbajnë, e përditësojnë, si dhe shkëmbejnë informacione me AKMC-në;”
- germa g, e pikës 2, të nenit 28, parashikon se: “brenda 2 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, krijon bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në nivel qarku, të cilën e mirëmban dhe e përditëson, si edhe shkëmben informacione me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe, sipas rastit, me prefektët e qarqeve fqinje.” Me këtë rregullohet mënyra e krijimit të vazhdimësisë së të dhënave, data bazës, dhe saktësimi të informacionit të trashëguar.
- neni 41 E drejta e kompensimit², parashikon: “1. Shteti shqiptar përgjigjet për dëmet që shkaktohen nga pasojat e një fatkeqësie. 2. Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e

² Ky nen ndërlidhet me germën a), të pikës 3, të VKM-së nr. 414, datë 08.07.2021, të ndryshuar, konkretisht: a) akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilëve janë dëmtuar nga njëfatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera, sipas kriterëve specifike të përcaktuara në aktetnënligjore që rregullojnë ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, neni 41;

<https://www.qbz.gov.al/eli/vendim/2021/07/08/414/df3f112-66d5-4935-a796-dbdfa12f4e67>

si dhe me VKM-në nr. 53, datë 1.2.2023 “Për Përcaktimin e Kriterëve dhe Procedurave të Akordimit të fondeve për Marrjen e Masave Parandaluese dhe Rehabilituese ndaj Fatkeqësive, në Infrastrukturën e Dëmtuar, si edhe në veprimtari të Tjera në Fushën e Mbrojtjes Civile”

<https://qbz.gov.al/eli/vendim/2023/02/01/53/84484eb1-8cb3-42e6-b06a-0e46dfef8ea0>

prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile. 3. Në rast se bashkitë nuk kanë fonde të mjaftueshme për kompensimin, atëherë i planifikojnë ato për vitin pasardhës, deri në masën e kompensimit të subjekteve të dëmtuara. 4. Në rast se vlera e kompensimit tejkalon 8 % të buxhetit të bashkisë, KMC-ja vendos që kompensimi të kryhet nga AKMC-ja. 5. Në çdo rast, kur shpallet gjendja e fatkeqësisë natyrore, kompensimi mund të bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.”

- neni 73 Dispozita kalimtare, “1. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile shndërrohet në Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, me hyrjen në fuqi të këtij ligji. 2. Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile do të vazhdojë të funksionojë, sipas strukturës ekzistuese, deri në miratimin e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, sipas parashikimit të këtij ligji dhe miratimit të strukturës e të organikës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”. Pra, qartazi ka pasur shndërrim nga nocioni Drejtori në Agjenci, ku kjo e fundit ka shtrirje më të zgjeruar të kompetencave në mbrojtjen civile në Republikën e Shqipërisë.

Në këtë kontekst, theksohet edhe domosdoshmëria e përmirësimit të efikasitetit të administratës shtetërore dhe publike në plotësimin e nevojave të qytetarëve dhe ekonomisë, për forcimin e përgjegjësisë dhe integritetit, gjë e cila nga ju nuk është zbatuar. Prandaj dhe moszbatimi i plotësimit të detyrimeve, tejzgjatja e proceseve për kompensimin dhe përmirësimin e situatës së të dëmtuarve, passjell përkeqësim të situatës dhe ekspozim edhe me të lartë të të dëmtuarve ndaj rreziqeve që ndodhin në të ardhmen qoftë të afërt apo të largët.

Organet e administratës shtetërore janë të detyruara që qytetarëve t’u sigurojnë, realizim të drejtë dhe efikas të të drejtave, lirive kushtetuese e ligjore, si dhe interesave të tyre të ligjshme gjatë një procedure administrative. Të drejta dhe interesa këto të vërtetuara dhe të njohura me ligj. Në ushtrimin e veprimtarisë tuaj duhet të udhëhiqeni nga parimi i ligjshmërisë dhe përgjegjshmërisë në kryerjen e detyrave funksionale të përcaktuara.

Në vijim të analizës sonë, theksojmë se, AKMC si një organ administrativ të ketë zbatuar detyrimet ligjore në kuadër të sigurimit të një procesi të rregullt ligjor.

Detyrimi për një proces të rregullt ligjor buron edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, si Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 6 i saj), i cili kërkon detyrimisht aplikim rigoroz nga instrumentet e brendshëm të një shteti.

Në respektim të këtij parashikimi, e drejta për një proces të rregullt ligjor është ngritur në nivel Kushtetues. Konkretisht neni 42, pika 1, e Kushtetutës, parashikon se: “*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cenohen pa një proces të rregullt ligjor*”, ndërsa neni 15, pika 2, e Kushtetutës parashikon se: “*Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre*”.

Institucioni ynë vlerëson se vonesa në trajtimin përfundimtar të praktikës së shtetasve z. Q. K. dhe znj. Sh. K., kufizon liritë dhe të drejtat e tyre të garantuara nga Kushtetuta dhe ligji, e më konkretisht, të drejtën e pronësisë.

Organet e administratës publike duhet të bëjnë përpjekjet maksimale për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor e në përputhje me nenin 6/1 të KEDNJ-së. Kjo procedurë, nuk është përfunduar në mënyrë të rregullt dhe nga një hetim i thelluar administrativ, nga ana e AKMC-së pa asnjë shkak të justifikuar ligjërisht, edhe pse është kërkuar vazhdimisht përfundimi i saj.

Sa sipër, ky institucion gjendet në shkelje të procesit të rregullt ligjor, në zhvillimin e procesit administrativ të kompensimit, në kushtet që edhe pse ka kaluar më tepër se një dekadë ende nuk është kompensuar në mënyrë përfundimtare ankuesi.

Konkretisht, më 03.11.2010 Këshilli i Komunës Pakuqan ka konfirmuar Vendimin nr. 40, datë 22.10.2010 “Për miratimin e kërkesës për ndihmë për familjet e z. Q. K. dhe H. K.”. Ndërsa në vitin 2013 familjes së z. Q. K. i është dhënë vetëm XXXX lekë.

Pra, për më shumë se 15 vjet nga përmbytja, nuk është ndërmarrë më asnjë veprim tjetër nga ana juaj në përmbushje të këtij detyrimi, e për pasojë jemi në kushtet kur nuk është mundësuar ende akordimi i plotë i ndihmës financiare për ankuesit Q. K. . Kjo ndihmë financiare e cila duhet të ishte dhënë brenda vitit 2013, pra pjesa e mbetur e kompensimit në vlerën XXX lekë, për t’u rimëkëmbur nga fatkeqësia, vazhdon dhe mbartet në kohë. Jemi në vitin 2025 dhe kjo vlerë në çdo vit shtyhet në kohë, me justifikimin që do parashikohet në buxhetin e ardhshëm të agjencisë.

Gjithashtu, akoma më flagrant mbetet fakti që institucioni i Avokatit të Popullit iu është drejtuar edhe më herët në vitet 2015 dhe 2016 për zgjidhjen përfundimtare të rastit të familjes Q. K. , por ende të pazbatuara, duke sjellë cenimin e mëtejshëm të të drejtave të ankuesve deri më sot. Legjislatori ka parashikuar si veçori themelore të institucionit të Avokatit të Popullit, edhe lehtësinë e kontaktimit, shpejtësinë dhe fleksibilitetin në kapjen e problemeve, si dhe mungesën e shpenzimeve, pasi veprimtaria e tij është pa pagesë. Moszbatimi i rekomandimeve, si sjellje, cenon rëndë marrëdhëniet tona institucionale, si dhe dëmton imazhin e institucionit të Avokatit të Popullit në publik.

Bazuar në nenin 63, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilin parashikohetse: “Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”, si dhe nenin 21, shkronja “b”, të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Pas përfundimit të hetimeve ,Avokati i Popullit kryen këto veprime..., b) paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”, c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”;

REKOMANDOJMË:

1. Marrjen e masave për akordimin e vlerës së pashlyer të ndihmës financiare në masën prej XXXXX lekë të familjes së z. Q. K. dhe znj. Sh. K. , ku sipas pikës 4/42, të VKM-së nr. 206, datë 26.03.1998, i jepet ndihma falas në masën 50% të vlerës së dëmit të banesës të përllogaritur në vlerën XXXXX lekë.
2. Shpërblimin e plotë të dëmit të shkaktuar ankuesit sipas parashikimeve e vlerës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
3. Marrjen e masave administrative dhe ligjore për mospërsëritjen e situatave të tilla në të ardhmen, pra të mosveprimit të institucionit tuaj, duke mos respektuar procedurat ligjore dhe të drejtat e shtetasve.

Në zbatim të nenit 22, të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,

K O M I S I O N E R E

Erinda MELI